



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/59
Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen procesverbalet nga mbledhjet 55 dhe 56 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/59

Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi" në Prishtinë, emërtimin e autostradës Prishtinë - Pejë - "Autostrada Adem Demaçi" dhe propozimin për të emërtuar Parkun e Qytetit të Prishtinës - "Parku Adem Demaçi"

1. Formohet Komisioni për vendosjen e shtatores së Adem Demaçit në sheshin "Adem Demaçi" në Prishtinë, emërtimin e autostradës Prishtinë - Pejë - "Autostrada Adem Demaçi" dhe propozimin për të emërtuar Parkun e Qytetit të Prishtinës - "Parku Adem Demaçi" në përbërje të:
 - 1.1. Përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës
 - 1.2. Përfaqësuesi i Ministrisë së Infrastrukturës
 - 1.3. Përfaqësuesi i Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës
 - 1.4. Përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit
 - 1.5. Përfaqësuesi i Agjencisë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale
 - 1.6. Përfaqësuesi i Komunës së Prishtinës
2. Komisioni ka për obligim që të fillojë procedurat për shpalljen e konkursit, përzgjedhjen, rregullimin e hapësirës në lokacionin sheshi Adem Demaçi, si dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të punëve deri në vendosjen e shtatores.
3. Komisioni ka për obligim që të fillojë procedurat e emërtimit të autostradës Prishtinë - Pejë - "Autostrada Adem Demaçi".
4. Komisioni ka për obligim që të përgatisë propozimin për emërtimin e Parkut të Qytetit - "Parku Adem Demaçi", dhe procesimin e të njejtit në Komunën e Prishtinës.
5. Zyra e Kryeministrit do të mbulojë shpenzimet për zbatimin e këtij vendimi.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/59

Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M


Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 01/18 të datës 11.03.2015

1. Themelohet Këshilli Ndërmintor për Ujërat, si trup koordinues dhe vendimmarrës që shqyrton çështjet sistemore të administrimit me ujëra, harmonizimin e nevojave dhe interesave të ndryshme, si dhe propozon masat për zhvillimin, shfrytëzimin dhe mbrojtjen e resurseve dhe sistemit ujor të Kosovës, në këtë përbërje:

1.1. Kryeministri i Republikës së Kosovës	Kryesues;
1.2. Ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	anëtar/e;
1.3. Ministri i Zhvillimit Ekonomik	anëtar/e;
1.4. Ministri i Financave	anëtar/e;
1.5. Ministri i Integritimit Evropian	anëtar/e.
2. Këshilli Ndërmintor për Ujëra jep mendime dhe rekomandime për:
 - 2.1. propozim ligjet dhe aktet tjera nënligjore që kanë të bëjnë me rregullimin e çështjeve nga fusha e ujërave në përgjithësi;
 - 2.2. zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore që kanë të bëjnë me menaxhimin e ujërave;
 - 2.3. hartimin dhe aprovimin e Strategjisë Shtetërore për ujëra;
 - 2.4. zhvillimin e politikave nga fusha e ujërave;
 - 2.5. zgjedhjen e politikave financiare nga fusha e ujërave.
3. Këshilli Ndërmintor për Ujërat kryen edhe detyrat tjera të përcaktuara me ligj.
4. Anëtarë të Këshillit pa të drejtë vote janë edhe Përfaqësuesi i Ambasadës Zvicerane (si koordinator i komunitetit të donatorëve në sektorin e ujërave) dhe një përfaqësues (me rotacion) i donatorëve aktiv në sektorin e ujërave.
5. Këshilli Ndërmintor për Ujërat do të ketë Sekretariatit e tij i cili do të ndihmojë në kryerjen e punëve dhe obligimeve të Këshillit. Sekretariati do të funksionojë në kuadër të Zyrës së Kryeministrit dhe do të përkraket nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim.
6. Sekretariati do të kryej detyrat dhe përgjegjësit e përcaktuara me rregulloren e punës të miratuar nga Qeveria.

7. Mjetet për shpenzimet e punës të Këshillit Ndërmintor të Ujërave sigurohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe nga përkrahja e donatorëve.
8. Këshilli Ndërmintor i Ujërave përgatit raporte vjetore të cilat i raporton para Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës.
9. Obligohen të gjitha Ministritë e linjës dhe palët e sektorit të ujërave të bashkëpunojnë, dhe ta përkrahin Këshillin dhe Sekretariatit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësi.
10. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë nr. 01/18 i datës: 11.03.2015.
11. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/59

Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Pjesëmarrjen e Kosovës në Programin Evropa Kreative për Mbështetjen e Sektorëve Kulturorë dhe Kreativë.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/59

Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për të Drejtën Ndërkombëtare Private.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/59

Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores QRK - Nr. 31/2013 për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e Rregullores nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/59

Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 12 të Ligjit Nr. 04/L-144 Për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për kërkesën e Komunës së Skenderajt për tërheqjen nga procesi i privatizimit të pronave të Kooperativës Bujqësore "Runik" me qëllim të realizimit të interesit publik.
2. Zonat Kadastrale të cilat janë objekt i këtij vendimi janë: Nr. i ngastrës 850; nr. 852/1; 1074, 1840.
3. Kompensimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në shumën prej njëzet për qind (20%) të vlerës së pronës sipas vlerësimit, për të kompensuar punëtorët e kualifikuar të Ndërmarrjes Shoqërore, si dhe kërkesat e kreditorëve nga procesi i likuidimit deri në shumën e përgjithshme të vlerësimit, do të bëhet sipas legjislacionit përkatës në fuqi.
4. Prona nga pika 2. e këtij vendimi, nuk mund të shfrytëzohet për qëllime të tjera, përveç destinimit të përcaktuar.
5. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal që të zhvillojë procedurat e mëtejme me Agjencionin Kosovar të Privatizimit, deri në vendimin përfundimtar për bartje të pronës.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/59

Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues Teknik për vlerësimin e të gjitha aseteve që janë në pronësi të Ndërmarrjes Shoqërore "Trepça" Sh.A. dhe përfshirja e të gjitha aseteve fizibile në Statutin e Shoqërisë Aksionare "Trepça" Sh.A.
2. Grupi Punues Teknik do të ketë këtë përbërje:
 - 1.1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik - dy përfaqësues;
 - 1.2. Zyra e Kryeministrit - një përfaqësues;
 - 1.3. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - një përfaqësues;
 - 1.4. Bordi i Trepçës - një përfaqësues;
 - 1.5. Menaxhmenti i Trepçës - një përfaqësues;
 - 1.6. Sindikata e Trepçës - dy përfaqësues;
 - 1.7. Ekspert i pavarur - një përfaqësues.
3. Grupi Punues Teknik udhëhiqet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, i cili përgatitë propozimin final për Qeverinë, jo më larg se tre (3) muaj pas miratimit të këtij vendimi.
4. Mandati i Grupit Punues Teknik përfundon me dorëzimin e propozimit final në Qeveri.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/59

Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues Teknik për trajtimin dhe ofrimin e zgjidhjeve për të gjitha çështjet sociale të ngritura nga Sindikata e Minatorëve të "Trepçës".
2. Grupi Punues Teknik do të ketë këtë përbërje:
 - 2.1. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - një përfaqësues;
 - 2.2. Ministria e Zhvillimit Ekonomik - një përfaqësues;
 - 2.3. Ministria e Financave - një përfaqësues;
 - 2.4. Zyra e Kryeministrit - një përfaqësues;
 - 2.5. Sindikata e Trepçës - një përfaqësuese;
 - 2.6. Ekspert i pavarur - një përfaqësues.
3. Grupi Punues Teknik udhëhiqet nga përfaqësuesi i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, i cili përgatitë propozimin final për Qeverinë, jo më larg se tre (3) muaj pas miratimit të këtij vendimi.
4. Mandati i Grupit Punues Teknik përfundon me dorëzimin e propozimit final në Qeveri.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/59
Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për shfuqizimin e Vendimeve nr. 02/57 të datës 17.07.2018 dhe nr. 15/58 të datës 24.07.2018

1. Shfuqizohen vendimet e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 02/57 i datës 17 korrik 2018 dhe nr. 15/58 i datës 24 korrik 2018.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/59
Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Diasporës dhe Investimeve Strategjike për negocimin e Marrëveshjes për Bashkëpunimin në Fushën e Diasporës ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Diasporës dhe Investimeve Strategjike obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/59
Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për lidhjen e Marrëveshjes për Sigurime Sociale në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Mbretërisë së Holandës.
2. Përgjatë negociimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/59

Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Propozim Vendimi i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për udhëzimin e Komunës së Obiliqit për angazhimin e (4) katër inspektorëve në Drejtorinë e Inspektionit, me qëllim të administrimit dhe kontrollimit të investimeve (ndërtimeve) në sektorin e ndërtimit dhe mjedisit në Komunën e Obiliqit, përkatësisht në Zonën e Interesit të Veçantë Ekonomik.
2. Obligohet Komuna e Obiliqit që stafin nga pika 1. e dispozitivit të këtij vendimi ta angazhojë duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-149, përkatësisht neni 12 paragrafi 4.
3. Sigurimi i mjeteve financiare për pagesën e Inspektorëve bëhet nga Komuna e Obiliqit.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Financave dhe Komuna e Obiliqit.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/59

Datë: 31.07.2018

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren nr. 14/2017, me Rregulloren nr. 15/2017, me Rregulloren nr. 16/2017 dhe me Rregulloren nr. 07/2018, si dhe në nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 2018, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës për përkrahjen në zhvarrosjen e heroit Rustem Bruqi dhe dëshmorëve Naim Bajraktaraj, Isa Balaj, Beqir Mehmetaj, Miftar Bajraktaraj dhe Avdyl Osdautaj dhe rivarrimit të tyre pranë Lapidarit të Dëshmorëve në Isniq, me ceremoni mortore ushtarake, sipas kërkesës së Kryetarit të Komunës së Deçanit, të datës 30.07.2018, me nr. prot. 22653.
2. Obligohet Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës dhe institucionet tjera përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë